



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 284

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË FIER, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", Z. ARMANDO SUBASHI, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën me:

KËRKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", me shkronja nistore "PS"

OBJEKTI: Regjistrimi i z. Armando Subashi si kandidat për kryetar të Bashkisë Fier, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72, 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", vendimi nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në mbështetje të neneve 67, pika 2, 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e z. Armando Subashi si kandidat për kryetar të bashkisë Fier.

Data: 5.4.2023 Nr: 284
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Fier, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", z. Armando Subashi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të nenit 67, pika 2, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Fier, pasi administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

- Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, Model KQZ-04-06,
- Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme, Model KQZ-04-08,
- Deklaratë për pranimin e kandidimit, Model KQZ-04-09,
- Jetëshkrimi i kandidatit, Model KQZ-04-10,
- Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatit për kryetar bashkie,
- Formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie,
- Procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit, Model KQZ-00-31.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie. Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidati për kryetar bashkie z. Armando Subashi propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk është në kushtet e ndalimit parashikuar nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 5.4.2023, verifikoi dokumentacionin e kandidimit të z. Armado Subashi, të depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, dhe vlerëson se është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 72, 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” dhe vendimin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Regjistrimin z. Armando Subashi, si kandidat për kryetar në Bashkinë Fier, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Data: 5.4.2023 Nr: 284
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Fier, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Armando Subashi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 5.4.2023 Nr: 284
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Fier, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", z. Armando Subashi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.